



**Datë: 13.09.2023**

### **Drejtoria Komunale për Arsim**

Mbështetur në nenin 62 pika 62.3 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisjen lokale (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, Qershor 2088), nenit 47 pika c). Të Statutit të Komunës së Fushë Kosovës nr. 98 datë: 30.07.2012, nenit 2, 3 dhe i Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë Kosovës nr.83 e datës 14.06.2013, dhe në mbështetje të vendimit me nr. 1315 të datës 13.09.2023, aprovuar nga Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë për Arsim me datë 13.09.2023 shpall:

### **THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM**

Për ndarjen e ndihmës momentale për nxënësit e Komunës së Fushë Kosovës

- Komuna e Fushë Kosovës ndanë ndihmë momentale për nxënësit e Komunës së Fushë Kosovës.
- Të drejtë aplikimi kanë vetëm nxënësit që janë banorë të Komunës së Fushë Kosovës pa kurrfarë dallime etnike, gjinore, fetare dhe politike.

Kategoritë e përfituesve janë :

1. Nxënësit me nevoja të veçanta;
2. Fëmijët/nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta;
3. Bartja (transporti) e nxënësve të cilët udhëtojnë në linjat:
  - Nakaradë - SHFMU “Selman Riza” Fushë Kosovë
  - Lagjja e Ronollëve - SHFMU Laura Scotti” Graboc i Poshtëm
  - Harilaq - SHFMU “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe
  - Bardh i Vogël - SHFMU “Bajram Curri” Sllatinë e Madhe
  - Harilaq i Vogël - SHFMU “Bajram Curri” Harilaq
  - Pomozotin – Shkolla Speciale “Përparimi” Prishtinë

Kriteret e përgjithshme për ndarjen e ndihmës momentale janë:

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës (dëshmi letërnjoftimi);
2. Për nxënësit me nevoja të veçanta- dëshmi vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
3. Fëmijët/nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta: dëshmitë sipas UA nr.14/2019 nga MASHT.

#### **I. Kriteret e përfitimit për nxënës me nevoja të veçanta:**

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës- dëshmi letërnjoftimi
2. Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i Komunës së Fushë Kosovës;
3. Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

#### ***Dokumentet e nevojshme për aplikim:***

- Formulari për aplikim (e gjeni te publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
- Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
- Letërnjoftimi i prindit;



- Vërtetimin nga shkolla ku vijon mësimin;
- Vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.

**II. Kriteret e përfitimit për fëmijët/nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta:**

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës – dëshmi letërnjoftimi
2. Vërtetimi nga shkolla që është nxënës i Komunës së Fushë Kosovës;
3. Dëshmitë sipas UA nr.14/2019 nga MASHT.

***Dokumentet e nevojshme për aplikim:***

- Formulari për aplikim (e gjeni te publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
- Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
- Letërnjoftimi i prindit;
- Vërtetimin nga shkolla ku vijon mësimin;
- Dëshmitë sipas UA nr.14/2019 nga MASHT
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.

\*Ata që kanë përfituar nga thirrja e parë nuk kanë të drejtë përfitimi nga kjo thirrje

**III. Kriteret e përfitimit për transportin e nxënësve:**

1. Të jetë banor i Komunës së Fushë Kosovës
2. Vërtetimi nga shkolla ku vijon mësimin;

***Dokumentet e nevojshme për aplikim:***

- Formulari për aplikim (e gjeni te publikuar bashkë me konkursin ose në zyrën pritëse në Komunën e Fushë Kosovës);
- Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
- Vërtetimi nga shkolla ku vijon mësimin;
- Letërnjoftimi i prindit;
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare.

**Vërejtje:** Dokumentet e pakompletuara dhe ato te dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do te shqyrtohen.

**Thirrja mbetet e hapur 15 dite nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve në faqen zyrtare të Komunës se Fushë Kosovës.**

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/category/shpalljet/konkurset/>

Konkursi mbetet i hapur nga data 13.09.2023 deri me date 28.09.2023

